

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

TELEGRAM NGUSHËLLIMI


I nderuar akademik Kraja,

Vdekja e papritur e bijës suaj ka tronditur thellë gjithë kolektivin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është kjo një dhembje e madhe për ju dhe për familjen, për miqtë dhe dashamirët tuaj dhe për të gjithë ata që e kanë njojur dhe e kanë dashur Arzana Krajën, regjisore e skenariste filmi, artiste e shquar dhe e dëshmuar me vepra të vlerësuara lart.

Duke qenë me ju dhe pranë jush në këto çaste tejet të hidhura, duke bashkëndjerë për humbjen e madhe që ju ka gjetur, ju lutem, në emër të të gjithë anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të stafit drejtues dhe të administratës, si dhe në emrin tim personal, pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta.

Për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Akademik Jusuf Bajraktari, nënkyrytar



Prishtinë, më 13 nëntor 2019